



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
KOMITETI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

V E N D I M

Nr. 1, datë 28.2.2019

P Ë R

**SHPLLJEN E THIRRJES SË PARË PËR FINANCIMIN
E PROJEKTEVE NGA GRANTET “ARSIMI BAZË”, “ARSIMI
I MESËM”, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE,
PËR VITIN 2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, dhe të aneksit 3, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

V E N D O S I:

1. Shpalljen e thirrjes së parë për financimin e projekteve të reja nga Fondi për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2019, sipas granteve të financimit, si më poshtë vijon:
 - 1.1. Grantet për “Arsimin”:
 - Granti “Arsimi bazë”;
 - Granti “Arsimi i mesëm”.
2. Drejtimit e thirrjes për financim janë:
 - a) rehabilitimi i objekteve arsimore ekzistuese në arsimin parauniversitar (arsimi bazë dhe i mesëm, përfshirë shkollat e mesme të bashkuara), të cilat paraqesin rrezik shembjeje dhe kanë nevojë emergjente për ndërhyrje;
 - b) ndërtimi i objekteve të reja arsimore në arsimin parauniversitar (arsimi bazë dhe i mesëm, përfshirë shkollat e mesme të bashkuara);
 - c) rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve të objekteve arsimore në arsimin parauniversitar (arsimi bazë dhe i mesëm, përfshirë shkollat e mesme të bashkuara), përmirësimin e infrastrukturës shkollore (arsimi

bazë dhe i mesëm, përfshirë shkollat e mesme të bashkuara), në zonat dhe fshatrat pjesë e “Programit të integruar për zhvillimin rural – Programi i 100 Fshatrave”, miratuar me vendim nr.21, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr.709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014–2020””, si dhe i kapaciteteve të shkollave si “Qendra komunitare”.

3. Për thirrjen, sipas pikës 1, të këtij vendimi, vlera e financimit të thirrjes së parë, për vitin 2019, është:
 - Granti “Arsimi bazë”: 341 935 708 milionë (lekë);
 - Granti “Arsimi i mesëm”: 330 361 410 milionë (lekë).
4. Vlera e bashkëfinancimit nga aplikuesi për çdo projekt sipas grantit është sipas shtojcës I, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Aplikimi për financimin e projekteve sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, si dhe nga njësitë e qeverisjes vendore, në marrëveshje partneriteti me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, sipas shtojcave II e III, bashkëlidhur këtij vendimi.
6. Procedura e vlerësimit të projekteve të aplikuara kryhet nga sekretariati teknik, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, sipas kritereve të dhëna në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.
7. Ngarkohen ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.


EDI RAMA

KRYETAR

Në mungesë dhe me porosi

ERION BRAÇE

ZËVENDËSKRYETAR



Zëvendëskryeministri
Ministri i Financave dhe Ekonomisë
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministri i Kulturës
Ministri i Brendshëm
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë

Zëvendëskryetar,
anëtar,
anëtar,
anëtar,
anëtar,
anëtar,
anëtar,
anëtar,
anëtar.

Shtojcë I: VLERA E BASHKËFINANCIMIT

Vlera e bashkëfinancimit për çdo projekt të jetë, si më poshtë vijon:

- a) Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë, vlera dysHEME e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore të jetë në masën 10% të vlerës së plotë të projektit, e që duhet të alokohet, nga buxheti i njësisë së qeverisjes vendore, për vitin 2019.
- b) Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi mbi 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) banorë, vlera dysHEME e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore, të jetë në masën 30% të vlerës së plotë të projektit, e që duhet të alokohet, nga buxheti i njësisë së qeverisjes vendore, përkatësisht, në vitin 2019, në masën 15% dhe në vitin 2020, në masën 15% (duke qenë se projekti zbatohet në dy vite).
- c) Për njësitë e qeverisjes vendore me popullsi mbi 100 000 (njëqind mijë) banorë, vlera dysHEME e bashkëfinancimit nga ana e njësisë së qeverisjes vendore, të jetë në masën 50% të vlerës së plotë të projektit, e që duhet të alokohet, nga buxheti i njësisë së qeverisjes vendore, përkatësisht, në vitin 2019, në masën 25% dhe në vitin 2020, në masën 25% (duke qenë se projekti zbatohet në dy vite).

Diferenca mes vlerës së projektit me vlerën e kontratës, nëse ka një të tillë, pas prokurimit publik do t'i zbritet financimit me burim grantin "Arsimi bazë" dhe grantin "Arsimi i mesëm", pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

SHËNIM:

Ministria e Brendshme dërgon listën e njërive të qeverisjes vendore me mbi dhe nën 50 000 (pesëdhjetë mijë) banorë dhe mbi 100 000 (njëqind mijë) banorë, pranë sekretariatit teknik në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

**Shtojcë II: KALENDARI ME AFATET E APLIKIMIT DHE
VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE**

Afati	Institucioni përgjegjës	Aktiviteti
Botimi në "Fletoren zyrtare"	Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve	Hapja e thirrjes për projekte të reja sipas drejtimeve të thirrjes së grantit, sipas pikës 2, të këtij vendimi.
7 ditë kalendarike nga botimi në "Fletoren zyrtare"	Aplikuesit sipas pikës 5, të këtij vendimi	<p>Dërgimi i aplikimeve nga aplikuesit, si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aplikimi <i>online</i> në faqen elektronike të <i>e-Albania</i>: Shërbimi: Aplikimi <i>online</i> për FZHR https://e-Albania.al/sherbimi.aspx?kodi=7203 ose 2. Aplikimi me shpresë zyrtare (postë ose protokollim dorazi), ku dosja e plotë e aplikimit (në CD) dërgohet pranë sekretariatit teknik, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. <p>Pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve (në Kryeministri), <u>nuk dorëzohen dosjet e aplikimit, por ato dorëzohen vetëm pranë sekretariatit teknik në ministri.</u></p>
10 ditë kalendarike nga mbyllja e aplikimit	Sekretariati teknik përkatës	Vlerësimi i projekteve të aplikuara, sipas shtojcës IV të këtij vendimi.
	Sekretariati teknik përkatës	Sekretariati teknik paraqet zyrtarisht pranë Sekretariatit të Përgjithshëm listën e projekteve që propozohen për financim, si dhe projekt vendimin që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

